



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office

Data/Datum/Date:	23.04.2025
Nr./Br./No	02/ 452
Për/Za/To:	z. Adnan Ademi Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës
Lënda/Predmet/Subj ect :	Propozim-vendim për plotësimin e anëtarëve në Komitetin për Komunitete në Komunën e Shtimes

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 pika (d), nenet 51 dhe 53 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, propozohet plotësimi i disa anëtarëve të Komitetit për Komunitete, si trup i domosdoshëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në nivel lokal.

Ky propozim vjen nga nevoja për ta plotësuar në tërësi me anëtarë Komitetin e përhershëm për Komunitete në Komunën e Shtimes, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia funksionale dhe përfaqësimi i drejtë në përbërjen e këtij Komiteti, pas propozimeve të pranuar nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e komuniteteve përkatëse.

Në këtë kuadër, propozohet që anëtarët Shkurte Mustafa, Shkurte Behluli dhe Muhamet Mehmeti, pas dorëheqjes së tyre, të lirohen nga detyra e anëtarit të Komitetit për Komunitete dhe të zëvendësohen me përfaqësues të rinj të propozuar nga të njëjtat subjekte/komunitete, për të ruajtur parimin e barazisë së përfaqësimit.

Emrat e anëtarëve të rinj do të përcaktohen në përputhje me propozimet e dorëzuara dhe në harmoni me strukturën ekzistuese të përfaqësimit në Komitetin për Komunitete. Ky zëvendësim do të ndihmojë në rritjen e efektivitetit dhe pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset vendimmarrëse lokale, në përputhje me frymën gjithëpërfshirjes.